**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA PUKË**
**KËSHILLI BASHKIAK**

**Nr.1969/3 prot:** **Pukë, më 08.11.2023**

**Lënda:** Dergojme vendimin e këshillit te Bashkise Puke nr.**34 datë 03.11.2023.**

**PREFEKTIT TE QARKUT**

**SHKODËR**

Në zbatim të germës **"a"** të nenit **8** dhe pikës **2** të nenit **16** të ligjit me nr.**107/2016,** "Për Prefektin e Qarkut", ju dërgojmë bashkëngjitur:

Vendimin e Këshillit Bashkiak Pukë **Nr.34** datë **01.11.2023 "Për një shtesë në vkb nr. 68 , datë 30.12.2022 për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 të Bashkisë Pukë"të ndryshuar ".**

*Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,*

**SEKRETARE**
Edona **HYSENAJ**

13/11/23

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA PUKË**
**KËSHILLI BASHKIAK**

**Pukë, më 08.11.2023**

**Nr.1969\2 prot:**

# VENDIM

## Nr. 34 datë 01.11.2023

"PËR NJË SHTESË NË VKB NR. 68 , DATË 30.12.2022 PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2023 DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2023-2025 TË BASHKISË PUKE TË NDRYSHUAR"

Këshilli Bashkiak Pukë në mbledhjen e tij të datës <u>01.112023</u> , me propozim të kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të ligji nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemii buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ligji nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar ; të ligjit nr. 84/2022 date 24.11.2022 "Për buxhetin e vitit 2023, te ndryshuar; ligji 68/2017 dt.27.04.2017 "Për financat e Qeverisjes Vendore ; VKM nr.113 datë 01.03.2023 "Për përcaktimin e pagës minimale ne shkallë vendi"; VKM nr. 241 datë 20.04.2023 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 175 dt. 08.03.2017 të KM "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi page të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë, në arsimin parauniversitar ",VKM nr. 325 dt. 31.05.2023 "Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit,funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civile dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike",VKM nr. 326 datë 31.05.2023 "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucioneve të administratës publike" ;VKM nr. 240 dt. 20.04.2023 Për një ndryshim në VKM nr. 350, datë 19.4.2017 "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin" të ndryshuar, VKM nr.328 date 31.05.2023 "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore", Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar ; Udhëzimi Plotësues nr. 2 datë 19.01.2023 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023 " , i ndryshuar ; VKB nr. 68 , datë 30.12.2022 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor aratmesëm përfundimtar 2023-2025 të Bashkisë Pukë" , i ndryshuar ; Shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.8321, datë 08.05.2023 me objekt "Dergohet rritja e pagave per funksionet e financuara me transferte sektoriale"dhe relacionit të administratës së bashkisë Pukë bashkëlidhur

## VENDOSI:

1.Miratimin e nje shtesës në VKB nr.68 , datë 30.12.2023 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 të Bashkisë Pukë" , i ndryshuar , në :

a. Programi 03280 "Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile".
b. Programi 04240 "Ujitja dhe kullimi" .

c. Programi 04260 "Administrimi i pyjeve dhe kullotave"
d. Programi 09120 "Arsimi bazë përfshirë parashkollorin"
e. Programi 09230 "Arsimi i mesëm i përgjithshëm"

nga zëri transferime korente te brendshme ( 604) te alokuara nga qeveria në shumën 4.189.118 lekë për funksionet e transferuara që mbulohen me burim financimi transfertë të pakushtëzuar sektoriale , te zëri paga (600) dhe sigurime shoqërore ( 601 ) për të mbuluar efektin e rritjes se pagave , si më poshtë:

Detajimi i shtesës së fondit me burim financimi Transferte te Pakushtëzuar Sektoriale

*Në Lekë*

| Emertimi i programit | Paga | Sigurime shoqerore | TOTALI | Institucioni |
|---|---|---|---|---|
| Programi 03280 "Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile"; | 430.800 | 90.000 | 520.800 | Drejtoria e Shërbimit té Mbrojtjes ma Zjarri dhe mbrojtja civile |
| Programi 04240 "Menaxhimi i infrastruktugs.së ujitjes dhe- kullimit" | 38.000 | 10.000 | 48.000 | Ujitja dhe kullimi |
| Programi 04260 "Administrimi i pyjeve dhe kullotave". | 557.000 | 115.000 | 672.000 | Administrimi I pyjeve dhe kullotave |
| Programi 09120 Asimi bazë përfshi parashkollorin | 1.000.000 | 200.000 | 1.200.000 | Arsimi parashkollore,punojës mbështetës |
| Programi 09120 Asimi bazë përfshi parashkollorin | 972.318 | 200.000 | 1.172.318 | Arsimi parashkollorë educator,punonjës arsimorë,punonjës në qendrat kulturore. |
| Programi 09230 Arsimi parauniversitar | 476.000 | 100.000 | 576.000 | Arsimit parauniversitarë |
| **TOTALI** | **3.474.118** | **715.000** | **4.189.118** | |

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3.Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55 pika 6 te ligjit . 139/2015 date 17.12.2015"Per vetqeverisjen vendore".

4. Miratuar me 8 vota pro, 0 kunder, 0 abstenim .

5. Shpallur me datë **08.11.2023**

**SEKRETARE**
Edona **HYSENAJ**

**KRYETARI I KESHILLI**
Eduard **GJOKA**